SKS 2022

# STUDENTËT VLERËSOJNË

**Rezultatet e Sondazhit Kombëtar të Studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në institucionet e arsimit të lartë**

SKS 2022

## AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

WWW.ASCAL.AL

# Raport mbi rezultatet e Sondazhit Kombëtar të Studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies në Institucionet e Arsimit të Lartë

**SKS 2022**

**ASCAL**

**AGJENCIA PËR SIGURIMIN E CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

**Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë, AL**

**info@ascal.al**

**www.ascal.al**

# PËRMBAJTJA

I. HYRJE ........................................ 4
II. KONTEKSTI DHE OBJEKTIVAT ........................................ 5
III. REZULTATE TË PËRGJITHSHME TË SONDAZHIT ........................................ 7
IV. REZULTATET ANALITIKE TË SONDAZHIT ........................................ 24
4.1. METODOLOGJIA DHE ZHVILLIMI I SKS 2022 ........................................ 24
4.2. CILËSIA E MËSIMDHËNIES NË IAL PUBLIKE DHE JO PUBLIKE .... 32
4.2.1. Seksioni 1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia ........................................ 32
4.2.2. Seksioni 2: Vlerësimi dhe feedback-u ........................................ 39
4.2.3. Seksioni 3: Burimet në funksion të mësimdhënies ........................................ 50
4.2.4. Seksioni 4: Organizimi dhe realizimi i programeve ........................................ 58
4.2.5. Seksioni 5: Mbështetja dhe zëri i studentëve ........................................ 65
4.2.6. Seksioni 6: Vlerësimi i përgjithshëm i programit /institucionit........ 71
V. ANALIZA KRAHASUESE DHE PËRFUNDIME ........................................ 86
VI. ANEKSE ........................................ 89
6.1. Formati i pyetësorit të studentëve ........................................ 89
6.3. Statistika të përgjithshme me rezultatet e SKS për Institucionin e arsimit të lartë ........................................ 108

# I. HYRJE

Ligji i Arsimit të Lartë (LAL) 80/2015, përcakton institucionet përgjegjëse për sigurimin dhe garantimin e cilësisë si dhe mekanizmat me të cilët ajo arrihet. Cilësia në arsimin e lartë garantohet nëpërmjet sigurimit të brendshëm të cilësisë ku përgjegjës janë vetë institucionet si dhe nëpërmjet sigurimit të jashtëm ku përgjegjëse janë Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), Bordi i Akreditimit (BA) si dhe ministria përgjegjëse për arsimin e lartë të cilat garantojnë arsim cilësor në përputhje me Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (KCAL). Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë është një nga sfidat më të vështira me të cilat ballafaqohen si institucionet e arsimore ashtu dhe institucionet politikë-bërëse. Kjo vështirësi rritet akoma më shumë nëse merren parasysh sfidat e shumë-fishta me të cilat përballet arsimi i lartë në Shqipëri dhe kërkesat gjithnjë në rritje të studentëve për arsim dhe shërbime akademike cilësore.

Si institucioni përgjegjës për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë, ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të ofruara.

Sondazhi Kombëtar i Studentëve (SKS) është një nga mekanizmat e monitorimit të cilësisë të cilin ASCAL ka për detyrë ta realizojë çdo 3 vjet në funksion të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në IAL dhe monitorimit të vazhdueshëm të saj. Ky proces realizohet prej disa vitesh, konsiderohet tashmë i konsoliduar.

Sondazh i parë i studentëve sipas përcaktimeve të LAL 2015, u realizuar në vitin akademik 2018 – 2019. Pavarësisht problematikave të evidentuara, SKS 2019 i shërbeu agjencisë dhe institucioneve të konsolidojnë procesin në mënyrë që ai të kthehet në kulturë nga institucionet dhe studentët.

SKS 2022 zhvillohet në vijimësi të procedurave që ASCAL dhe BA kryejnë në funksion të përmbushjes së misionit të tyre në fushën e sigurimit të cilësisë. Gjatë vitit 2021 sistemi i sigurimit të cilësisë pati ndryshime rrënjësore duke filluar me riorganizimin e Bordit të Akreditimit me anëtarë të rinj, personalitete të njohura akademike brenda dhe jashtë vendit, riorganizimin e ASCAL dhe ndryshime në VKM 109 për funksionimin e ASCAL dhe BA si dhe plotësimin dhe miratimin përfundimtar të Kodit të Cilësisë me të gjitha standartet e nevojshme për vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve dhe programeve të studimit.

Në reflektim të këtyre ndryshimeve është organizuar dhe përmbajtja e SKS 2022. Ky raport paraqet në mënyrë përmbledhëse qëllimin, metodologjinë, organizimin, zbatimin dhe rezultatet e SKS për institucionet e arsimit të lartë. Publikimi i këtyre rezultateve nuk ka për qëllim vlerësimin krahasimor midis institucioneve publike por synon të paraqesë të dhëna faktike e statistikore për panoramën e arsimit të lartë në IAL-të publike *nga këndvështrimi i studentëve*. Raporti është një referencë e besueshme për ASCAL, BA, IAL, MAS dhe studentët, për të patur një pamje të qartë mbi sistemin arsimor në vend parë nga këndvështrimi i studentëve.

# II. KONTEKSTI DHE OBJEKTIVAT

Sondazhi i Studentëve është një instrument periodik për sigurimin e cilësisë i parashikuar në LAL 2015 dhe një nga detyrat funksionale të ASCAL. Pyetësorët dhe sondazhet janë metodologji të njohura ndërkombëtarisht që përdoren jo vetëm për vlerësimin e mësimdhënies por edhe për të mbledhur informacione dhe kryer analiza për funksionimin e sistemit të arsimit të lartë në tërësi. Këtë mekanizëm e përdorin jo vetëm institucionet që sigurojnë cilësi në arsim por edhe vetë institucionet që ofrojnë edukim. Marrja e mendimit të studentëve mbi cilësinë e mësimdhënies që ofron institucioni i tyre, është një instrument kyç për vlerësimin e IAL-ve dhe sigurimin e cilësisë qoftë pjesë e vlerësimit të brendshëm ose e atij të jashtëm.

SKS ka si qëllim kryesor sigurimin dhe rritjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancën e institucioneve në kuadër të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kompetencave nga këndvështrimi i studentëve. Kontributi i SKS është në disa drejtime duke dhënë një impakt të rëndësishëm në kontekstin e arsimit të lartë. Ai jep informacione reale e të besueshme - për ASCAL, Bordin e Akreditimit (BA), ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe publikun, mbi cilësinë e arsimit të lartë bazuar tek opinioni i studentëve. Njëkohësisht ndihmon vendimmarrjen dhe hartimin e politikave në fushën e arsimit me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë. Përfshirja e studentëve në jetën akademike të institucioneve të tyre duke vlerësuar dhe dhënë mendime me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies është një tjetër kontribut që jep SKS. Sondazhi jep informacione të nevojshme për drejtuesit e institucioneve, administratorët etj., në hartimin e politikave të zhvillimit të institucioneve bazuar në nevojat dhe kërkesat e studentëve.

Së fundmi, informacioni që sigurohet nëpërmjet SKS, është i rëndësishëm për studentët aktualë mbi cilësinë e arsimit të lartë në institucionet ku ata studiojnë dhe njëkohësisht ndihmon studentët e rinj me informacione për cilësinë e mësimdhënies në IAL dhe publikun në tërësi për mendimin e studentëve mbi cilësinë e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.
ASCAL rithekson rëndësinë që kanë procese të tilla jo vetëm në sigurimin e cilësisë por veçanërisht në ndërgjegjësimin e studentëve se përfituesit kryesorë të shërbimeve universitare janë vetë ata dhe roli i tyre është i rëndësishëm në jetën akademik e të një institucioni

Në SKS 2022 janë përfshirë 39 institucione të arsimit të lartë publike dhe jo publike me një numër total prej 112743 studentësh. ASCAL ka bashkëpunuar ngushtësisht me Këshillat Studentorë në institucionet e arsimit të lartë në çdo fazë të SKS. Studentët janë përfshirë në diskutime dhe në dhënien e opinioneve me qëllim përmirësimin dhe thjeshtimin e përmbajtjes dhe procedurave të SKS.
Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së institucioneve të arsimit të lartë në Shqipëri nëpërmjet SKS kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar për arsimin e lartë dhe sigurimin e cilësisë dhe bazohet në praktikat më të mira të ndjekura në vendet e zhvilluara.

Për të koordinuar procesin brenda institucionit janë ngritur grupe pune në përbërje të të cilave ka patur edhe studentë. Institucionet kanë vënë në dispozicion të ASCAL listën e plotë të studentëve aktivë dhe adresat e tyre elektronike (e-mail). Gjatë fazës së plotësimit të pyetësorëve IAL-të kanë vënë në dispozicion të studentëve, salla dhe laboratorë informatike në mënyrë që studentët të plotësojnë pyetësorët. IAL- të kanë informuar studentët por në asnjë rast nuk kanë patur të drejtë të ndikojnë në gjykimin dhe vlerësimin e tyre.

Institucioni kryesor që ka përgjegjësinë ligjore të realizimit të SKS është ASCAL i cili ka administruar procesin, ka hartuar dhe zbatuar metodologjinë dhe instrumentet e zhvillimit të sondazhit. Gjatë gjithë fazës së zhvillimit, ASCAL në bashkëpunim me IAL, ka ndjekur kalendarin e aktiviteteve dhe planin e veprimtarive për zhvillimin e SKS së bashku me parashikimet e kapaciteteve të nevojshme financiare dhe njerëzore.
Për zbatimin e SKS janë ngritur grupet e punës që janë marrë me zhvillimin e veprimtarive të parashikuara në faza të ndryshme të SKS.
ASCAL dhe BA kanë miratuar përmbajtjen e pyetësorit pas një diskutimi të gjërë duke marrë në konsideratë qëllimin kryesor që ka SKS për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe njëkohësisht të marrë edhe informacione të tjera të propozuar nga ASCAL. Në përfundim të procesit, BA shqyrton raportet përfundimtare të SKS në kuadër të vendimmarrjes para publikimit të tyre. Në raste të caktuara BA propozon ndryshime / përmirësime të Manualit, procedurës, kuadrit ligjor dhe politikë-bërjes për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë.

# III. REZULTATE TË PËRGJITHSHME TË SONDAZHIT

Ky seksion jep një përmbledhje të rezultateve të përgjithshme të pyetësorit lidhur me disa nga treguesit kryesore të tij. Pyetjet e grupuara në 6 fusha vlerësimi janë paraqitur për lloje të ndryshme institucionesh, kategori programesh dhe studentësh etj.

Një nga problematikat kryesore të vërejtura në këtë sondazh është përsëri pjesmarrja e ulët e studentëve në plotësimin e tij. Referuar analizave të databazës së përftuar nga SKS, rezulton se në total nga të gjitha IAL janë vënë në dispozicion 113136 kontakte të sakta studentësh në të gjitha ciklet e studimit. Nga këto e-maile, pas verifikimit të kryer nga ASCAL, rezultoi se 112743 (83616 IALP, 29127 IALjP), plotësonin kriterin e një adrese e-maili që suportohej nga platforma e SKS.

Nga pyetësorët e dërguar, janë plotësuar plotësisht 15638 ose 24329 (plotësisht dhe pjesërisht). Plotësimi për institucionet publike është rreth **17.1 %** që janë kontaktuar ndërsa, **34.2 %** IALjP të cilët përbëjnë **21.57 %** të totalit të studentëve. Nëse llogarisim raportin e studentëve pjesmarrës sipas llojit të institucionit, rezulton se 59 % janë nga IALP dhe dhe 41 % në IALjP.




Numri i studentëve në IAL publike dhe jo publike

**Krahasuar me SKS 2019, nga 89519 (66905 IALP, 22614 IALjP), sondazhe të dërguara janë plotësuar plotësisht 15591 sondazhe me një mesatare[1] plotësimi për çdo institucion në vlerën 31.2 % (25.67 % IALP, 36.8 % IALjP). Në nivel kombëtar, përqindja e pyetësorëve të plotësuar në raport me numrin e dërguar, kjo vlerë është 17.4 % (14.8 %**
për IALP dhe 25.1 % në IALjP).

[1] Pëqindja e pjesmarrjes është llogaritur nga mesatarizimi i pjesmarrjes të çdo institucioni publik dhe privat duke i dhënë në këtë mënyrë peshën reale që ka çdo student në institucionin e vet.

Nga sa më sipër, SKS 2022 ka përmirësime në pjesmarrje të studentëve krahasuar me SKS 2019.
Pyetësori është plotësuar pjesërisht nga 24329 studentë ose plotësisht nga 15638 studentë përkundrejt totalit prej 112743 kontaktesh të dërguara numër i cili nuk reflekton numrin real të studentëve që studiojnë në arsimin e lartë. Disa institucione kanë dërguar numër më të vogël kontakte studentësh se sa kanë studentë realisht.

Numri i studentëve që janë përgjigjur është më i madh në institucionet publike (59 % me 41 %) sikundër tregohet në grafikun e mëposhtëm por në raport me totalin prej 24329 studentësh, përqindja e pjesëmarrjes së studentëve në institucionet jo publike është më e lartë.

Krahasuar me SKS 2019, pjesëmarrja e studentëve është ulur çka reflekton një mos-interes nga ana e studentëve pavarësisht njoftimeve të vazhdueshme të bëra nga ana e institucioneve dhe shtyrjes së afatit të përfundimit të sondazhit. (shih seksionin 4.2)

ASCAL dhe institucionet duhet të ndërmarrin hapa konkrete për të rritur pjesëmarrjen dhe besimin tek studentët lidhur me sondazhin. Shembuj dhe praktika promovuese mund të aplikohen për të integruar studentët në këto procese të rëndësishme brenda institucioneve të tyre.

Për të patur një ide më të qartë rreth mënyrës së plotësimit të pyetësorit nga studentët ne kemi shqyrtuar kohën mesatare të harxhuar nga studentët në përgjigjen e pyetjeve.




Koha e shpenzar për plotësimin e SKS

Sikundër shihet në grafikun e mësipërm, në shumicën e pyetjeve studentët përgjigjen shpejt dhe pa u menduar për përgjigjen që duhet të japin. Nga një simulim paraprak, në kemi vlerësuar se koha e nevojshme për plotësimin normal të pyetësorit është rreth 15-20 minuta e cila në shumë pak raste është arritur nga studentët.Koha mesatare e shpenzuar është rreth 5-7 minuta. Ky tregues tregon

**Përgjigjet në raport me numrin e studentëve të kontaktuar për çdo IAL**




seriozitetin me të cilin studentët kanë plotësuar pyetësorin dhe sa ndikon ai në bësueshmërinë e tij.

Në mënyrë krahasuese, në grafikun e mëposhtëm jepet përqindja e pjesëmarrjes për çdo institucion në raport me numrin total të studentëve që kanë marrë pjesë në SKS

Sikundër shihet, kontributi kryesor në sondazh (në raport me numrin total të studentëve), jepet nga institucionet publike si UMT 8.55%, UE 7.79% UT 6.95 % etj dhe disa nga institucionet jopublike si, AU 4.69 %, UAL 4.43 %, UET 4.23 % në raport me totalin. Me raportin e pjesëmarrjes 60% IAL publike dhe 40 % IAL jo publike, mendimi i studentëve nga IAL publike është dominues.

Në raport me numrin e studentëve që ka çdo institucion, përqindja e pjesëmarrjes së studentëve është ndryshe duke nxjerrë qartësisht në pah se pjesëmarrja në institucionet publike, (veçanërisht në institucionet e mëdha) është mjaft e ulët në raport me numrin total të studentëve. Për më tepër, në disa institucione rezulton të mos jenë vëne në dispozicion kontaktet e të gjithë studentëve të tyre.
Ndërkohë në institucionet jo publike dhe në disa institucione publike relativisht të vogla, pjesëmarrja është më e lartë. Në aneksin e raportit jepen të detajuara në përqindje pjesëmarrjet për çdo institucion dhe kontributi i studentëve për çdo pyetje (statistikat individuale për çdo IAL).

E ritheksojmë se përqindja e pjesëmarrjes ka jo vetëm rëndësi statistikore në përpunimin e të dhënave, por rrit besueshmërinë e tyre përkundrejt rezultateve që nxirren. Për shkak të specifikave dhe kompleksitetit që mbart analiza e të dhënave në pjesëmarrje relativisht të ulët, ky raport nuk del me konkluzione përfundimtare në lidhje me cilësinë e të dhënave dhe besueshmërinë e tyre në nivel institucional (në të gjitha IAL). Rezultatet dhe përfundimet përmbledhëse për institucionet të paraqitura në seksionin 4, janë interpretuar statistikisht më shumë si vlerësim i vetë studentëve mbi institucionet e tyre dhe jo në përmbajtje pa përdorur metoda stistikore vlerësimi e peshimi të indikatorëve.

Në sondazhet e ardhshme, ASCAL duhet të ndërtojë paralelisht edhe një metodologji verifikimi për certifikimin e të dhënave dhe nivelin e besueshmërisë së tyre ku përveç metodave statistikore, duhet të parashikohen për tu analizuar edhe një set pyetjesh lehtësisht të verifikueshme nga burime të ndryshme informacioni.
Një verifikim të tillë ASCAL e ka kryer pjesërisht në këtë proces duke analizuar rezultatet e Sondazhit Kombëtar të Studentëve të zhvilluar në vitin 2019 (SKS 2019)

Përqindja e kontributit të studentëve të çdo institucioni në SKS




Pjesmarrja në % e studentëve në SKS 2022 në raport me numrin e studentëve të dërguar nga çdo IAL
UL 17
UNYT 44
AU 36
UZKM 21
A.MARUBI 68
KU QIRIAZI 42
TESS 64
UPOLIS 58
UAL 48
SHL NEHEMIA 65
KU… 48
UET 30
KU BEDËR 34
U.EPOKA 26
KU WISDOM 56
KUB 43
CIT 55
TBU 48
UMSH 23
U.Metropolitan 33
KU LOGOS 72
KPT 77
UB 31
KU REALD 60
AI 47
USH 23
UST 37
UK 38
UGJ 41
UBT 09
UARTE 37
UAMD 25
UE 14
UV 11
UMT 34
AS 83
UT 08
UPT 12
AFA 96
00
20
40
60
80
100
120

Përsa i përket kategorive të ndryshme të studentëve pjesëmarrës në sondazh rezulton se studentët femra kanë angazhimin shumë më të madh përkundrejt studentëve meshkuj. Në nivel kombëtar, pjesëmarrja e studentëve femra është më shumë se dyfishi i pjesëmarrjes së studentëve meshkuj

Në grafikun në vijim paraqitet niveli i pjesëmarrjes sipas gjinisë në nivel institucional në raport me numrin total të studentëve.




Pjesmarrja e studentëve në pyetësor sipas gjinisë

Studentët e nivelit bachelor kanë pjesëmarrje më të lartë se studentët e ciklit të dytë dhe të tretë.


Pjesmarrja e studentëve sipas përkatësisë gjinore në çdo IAL
Pa deklaruar
Femër
Mashkull
UZKM
UV
UT
UST
USH
UPT
UNYT
UMT
UMSH
UMetropolitan
UMB
UL
UK
UGJ
UFO
UET
UE
UD
UBT
UAL
UA
U_Polis
TES
TBU
Nehemia
KUB
KU_WISDOM
KU_REALD
KU_Qiriazi
KU_Pavarësia
KU_LOGOS
KU_Bedër
KPT
EPOKA
CIT
AS
AI
AFMM
AFA
0
500
1,000
1,500
2,000
2,500

Në grafikun e mëposhtëm jepet kontributi që ka dhënë ccdo program studimi. Në përqindjen më të madhe, sondazhi është plotësuar nga studentët e ciklit të parë të cilët duhen vlerësuar për këtë angazhim të tyre.
Nga ana tjetër pjesmarrja më e ulët e studentëve të ciklit të dytë (numri i studentëve në arsimin e lartë që studiojnë në CII, është më i ulët), ul nivelin e besueshmërisë në disa pyetje që lidhen kryesisht me angazhimin e studentëve në veprimtari kërkimore, studime e projkete.







Ndërsa si grupmoshë kryesore janë studentët midis 18-22 vjeç. Bie në sy përqindja e lartë e studentëve që kanë një moshë më madhore çka në gjykimin tonë nuk është e vërtetë. Kjo tregon mos-seriozitet në plotësimin e sondazhit nga ana e studentëve duke ulur njëkohësisht dhe besueshmërinë e tij.

Përsa i përket përzgjedhjes së programeve të studimit në fazën e hyrjes në universitet, rreth 75% e studentëve në nivel kombëtar deklarojnë se studiojnë në programe studimi që ka qënë zgjedhje e parë e tyre.
Duke krahasuar të dhënat ndërmjet institucioneve publike e jo publike rezulton se në IAL publike rreth 73 % e studentëve studiojnë në një program studimi që ka qënë zgjedhje e parë e tyre përkundrejt 78 % që studiojnë në IAL jo publike.









Nga rezultatet e vlerësimit vërehet rezultat i lartë në përzgjedhjen e programit nga matura shtetërore duke nënvizuar se maturantët janë të informuar për programet ku duan të studiojnë sipas preferencës së tyre.

Nga analiza e rezultateve të mësipërme vihet re se për të gjithë treguesit, mbizotëron vlerësimi "shumë mirë" dhe "mirë". Vlerësimi i studentëve në institucionet jopublike është shumë më pozitiv se në institucionet jo publike. Gjithahstu rezulton të kemi një numër të madh studentësh, rreth 30 %, që kanë plotësuar pyetësorin por nuk janë shprehur për këtë pyetje.

Nëse krahasojmë të dhënat me sondazhin e fundit të kryer në nivel kombëtar SKS 2019, për të gjithë treguesit e mësipërm, ka përmirësim të mendimit të studentëve veçanërisht në institucionet publike. Në këtë rezultat mund të kenë ndikuar disa faktorë faktorë. P.sh zhvillimi i SKS 2019 fill pas protestës së studentëve ka ndikuar negativisht në perceptimin e studentëve për institucionet e tyre.

Ndërkohë masat e marra nga institucionet në përmbushje të kërkesave të studentëve, aplikimi i metodave të reja të mësimdhënies gjatë pandemisë Covid 19 apo shfrytëzimi në masë i teknologjisë së informacionit ka ndikuar në përmirësimin e vlerësimit të studentëve për metodat e mësimdhënies që aplikon personeli akademik, përdorimin e literaturës elektronike etj.

Nga analiza e përgjithshme, rezulton se opinioni i studentëve lidhur me cilësinë e arsimit të lartë në vend, mbështetja ndaj studentëve, metodat e mësimdhënies, cilësia e programeve të studimit, cilësia e personelit akademik dhe administrativ, është në nivel të mirë ose shumë mirë.

Ky vlerësim mbështetet gjithashtu nga përgjigjet që kanë dhënë studentët lidhur me pyetjen nëse ata do të rizgjidhnin të njëjtin institucion dhe program studimi ku sikundër shihet në grafikun e mëposhtëm rreth 70 % e studentëve që janë përgjigjur, aprovojnë se do të bënin të njëjtën zgjedhje

Krahasuar me rezultatet e SKS 2019, për të njëjtën pyetje, vlerësimi është rreth 10 % më i përmirësuar në institucionet publike.







Nëse i analizojmë të ndara, rezultatet tregojnë se në institucionet jopublike, përqindja e studentëve që do të rizgjidhte programin/institucionin është rreth 20 % më e lartë se në IAL publike







Në përfundim të kësaj analize të përgjithshme, rezulton se nga studentët që kanë marrë pjesë në sondazh (24329 studentë), pyetjes për cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri i janë përgjigjur rreth 64 % e tyre (36 % e studentëve të përfshirë në pyetësor, nuk kanë dhënë përgjigje, (24% e studentëve të përgjigjur në IAL publike dhe 12% e studentëve të përgjigjur në IAL private).

Referuar grafikut të mëposhtëm, rreth 30% e tyre e vlerësojnë shumë mirë 30 % mirë cilësinë e arsimit të lartë në vend, 21 % e vlerësojnë atë në nivel mesatar dhe rreth 8% e studentëve që janë përgjigjur e vlerësojnë në nivel të keq ose shumë të keq.




Nëse shohim të ndara vlerësimet e studentëve në institucionet publike dhe private, rezulton se në institucionet jopublike vlerësimi shumë mirë është rreth 40 % krahasuar me 20 % që është në institucionet publike. Edhe vlerësimi "shumë keq" në IAL publike, është shumë më i lartë se në institucionet jopublike.






Nga sa më sipër, duke krahasuar institucionet publike e jo publike të ndara, rezulton se studentët në IAL jo publike vlerësojnë më pozitivisht cilësinë e arsimit në institucionet e tyre.

Para se të vijojmë me analizën e detajuar të të dhënave të SKS, ritheksojmë se sikundër në SKS 2019, edhe në SKS 2022, rezulton të kemi një besueshmëri të ulët në përgjigjet e dhëna nga studentët në tërësi dhe nga kategori të ndryshme institucionesh në veçanti.

Është vërejtur se ka dallime midis përgjigjeve të studentëve që studiojnë në institucione të mëdha dhe në institucione të vogla, institucioneve kryesore në vend dhe institucioneve të lokalizuar në qytetet e tjera. Nga analiza e rezultateve, rezulton se studentët që studiojnë në IAL-të e mëdha publike në Tiranë shprehin më shumë pakënaqësi se studentë që studiojnë në IAL më të vogla publike kryesisht të lokalizuara jashtë Tiranës.

Duhet patur parasysh se verifikimi i këtij vlerësimi (pra nëse studenti është i kënaqur realisht nga institucioni apo tenton të paraqesë situatën më pozitive) është mjaft i vështirë por më së shumti lidhet me paqartësinë e studentit për të thënë të vërtetën (pa përjashtuar edhe përfshirjen e institucioneve në orientimin e studentëve). Studentët ende nuk janë ndërgjegjësuar se institucionet e tyre bëhen me cilësore dhe konkurues nëse realiteti paraqitet sikundër është, për t'i ndihmuar ato të përmirësohen sepse vetë sigurimi i cilësisë në arsim, është proces i vazhdeshëm.

Ka dallime të mëdha në pjesëmarrje të studentëve midis institucioneve të vogla dhe të mëdha (figura pjesëmarrja në % e studentëve në raport me numrin total). Është konstatuar kohë më e shkurtër në plotësimin e SKS nga studentët e IAL-ve çka tregon më së shumti një plotësim mekanik të pyetësorit se sa vlerësim apo dhënie mendimi (nga kjo tregohet edhe mënyra e plotësimit të pyetësorit nga këta studentë duke analizuar IP-në nga ku është plotësuar SKS si dhe koha e shpenzuar për plotësimin e SKS). Rezulton një numër i lartë pyrtësorësh të pa plotësuar por vetëm të hapur çka vështirëson

analizat statisikore e krahasuese ndërmjet institucioneve apo kategorive të ndryshme të tyre.

Për shkak të numri të ulët të studentëve në disa institucione, vlera e vogël e devijimit standard tregon një nivel të lartë homogjeniteti mendimi dhe vlerësimi, ç'ka nuk përmbush pritshmëritë e një shpërndarje statistikore.

Niveli pozitiv i vlerësimit në institucionet e vogla apo jashtë Tiranës, në shumicën e pyetjeve paraqet një realitet tjetër (si p.sh dëshirën që institucioni i tyre të dalë sa më të mirë, duke u përgjigjur pozitivisht në disa raste deri në 90 % të pyetjeve) por që nuk përputhet me të dhënat dhe informacionet që ASCAL disponon nga proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit.

Për këtë arsye, përfundimet për vlerësimin final, duhet të verifikohen edhe me informacione dhe të dhëna shtesë për një gjykim sa më të drejtë mbi perceptimin e studentëve. Edhe në rastet kur devijimi standard është statistikisht korrekt, vlerësimi e mendimi i studentëve në lidhje me plotësimin ose jo të pritshmërive të tyre nga ana e institucioneve, mund të mos jetë një paraqitje reale në nivel kombëtar p.sh kur krahasojmë vlerësimin ndërmjet institucioneve publike e jopublike.

Përveç problemit që lidhet me diferenca të mëdha të numrit të studentëve për IALP të ndryshme, përgjigjet e dhëna kanë nivele të ndryshme interpretimi pasi në rastet kur statistikisht besueshmëria e të dhënave është e ulët, nuk është e ndershme që përfundimet të jepen në nivel krahasues si të dhëna të besueshme.

Një indikator tjetër që tregon besueshmërinë e informacionit të paraqitur ka qenë vijueshmëria e mendimit dhe vlerësimit në pyetësorët e institucioneve. Vlerësimi që i kërkohet studentëve në fushat nga 1 në 5, u rikërkohet në mënyrë të përmbledhur në seksionin 6, "*Vlerësimi i përgjithshëm*",çka tregon se studentët nuk janë përqëndruar plotësisht në plotësimin e pyetjeve ose në shumicën e rasteve ato janë plotësuar pa u menduar.

Vlerësimi i besueshmërisë nëpërmjet kohës së shpenzuar në plotësimin e SKS, është kryer në total për të gjitha IAL-të dhe për çdo pyetje. Koha e shpenzuar në plotësimin e sondazhit lidhet edhe me numrin e ndërveprimeve që kanë patur studentët me pyetësorin, e shprehur kjo edhe me komentet e dhëna në disa nga pyetjet e SKS. Në këtë raport është analizuar statistikisht të gjitha fushat duke vlerësuar fillimisht rezultatet e përgjithshme e mandej ato në mënyrë krahasuese midis institucioneve publike dhe jo publike.

Në analizën e detajuar në vijim, pavarësisht subjektivizmit që mbartin rezultatet ne kemi identifikuar indikatorët e vlerësuar pozitivisht nga studentët si dhe ato që duhet të adresohen nga institucionet e arsimit të lartë në të ardhmen.

Në sondazhet e ardhshme, ASCAL duhet të ndërtojë paralelisht edhe një metodologji verifikimi për certifikimin e të dhënave dhe nivelin e besueshmërisë së tyre. Në metodologjinë e re përveç metodave statistikore, duhet të parashikohen për tu analizuar edhe një set pyetjesh lehtësisht të verifikueshme nga burime të ndryshme informacioni. Një verifikim të tillë ASCAL e ka kryer pjesërisht në këtë proces duke analizuar rezultatet e

pyetësorëve të mëparshëm të zhvilluar dhe rezultatet e akreditimeve të kryer në vite

# IV. REZULTATET ANALITIKE TË SONDAZHIT

## 4.1. METODOLOGJIA DHE ZHVILLIMI I SKS 2022

ASCAL ka zhvilluar disa sondazhe dedikuar vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies, Për hartimin e pyetjes dhe metodologjisë që ndiqet, ASCAL dhe BA, në vitin 2017 kanë hartuar dhe miratuar metodologjinë e zhvillimit të SKS si dhe si dhe rëndësinë e përdorimit të rezultateve. Bazuar në këtë metodologji, janë organizuar dy pyetësorë të rëndësishëm në nivel kombëtar.
Për SKS 2022, metodologjia e ndjekur është rishikuar dhe miratuar duke reflektuar në të eksperiencën e fituar nga SKS 2019 si dhe duke vënë theksin tek principet themelore të sondazhit si anonimati, e drejta për t'u përgjigjur ose jo, si dhe pavarësi në përgjigje dhe mos-ndikim nga rrethanat apo opinionet e tjera.

Sikundër kemi theksuar, rezultatet e SKS nuk kanë fuqi vendimmarrëse por duhet të jenë pjesë e analizave, propozimeve, sugjerimeve dhe ndryshimeve me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në arsimin e lartë. U hartuan 6 seksionesh pyetjesh/fusha vlerësimi në të cilat kërkohen informacione lehtësisht të evidentueshme nga studentët. që kërkohen dhe qëllimi për të cilin kryhet, përgatiten indikatorët, dhe pyetjet për çdo kategori.
Synimi kryesor ka qënë përgatitja e një grupi pyetjesh në mënyrë që të plotësohen lehtësisht nga studentët deri në fund të tij. Grupi më i madh i pyetjeve ka qenë në formatin mendim për një aspekt të caktuar, vlerësim për një proces ose shërbim, dakordësi për një ose disa opsione të dhëna me të drejtën e vlerësimit nga 1 në 5 duke filluar nga vlerësimi minimal në vlerësimin maksimal. Disa pyetje kanë qenë mohuese/pohuese ose në formatin e komenteve të shkurtra tekst me qëllim që studenti përveç vlerësimit të kishte të drejtën edhe të shprehjes. Rezultati final është bazuar vetëm mbi përpunimin e të gjitha përgjigjeve/mendimeve të dhëna nga studentët.

Në Manualin e SKS, është vendosur që për të gjitha IAL-të që kanë më shumë se 500 studentë, që sondazhi të konsiderohet i besueshëm, duhet të plotësohet në mënyrë të plotë nga të paktën 10 % e numrit total të studentëve të pyetur. Në rastet kur IAL ka numër të vogël studentësh, (50 < nr <500), numri i studentëve që duhet të plotësojnë pyetësorin në raport me numrin total duhet të jetë > 50% dhe në rastet kur numri i studentëve është më i vogël se 50, nuk kryhet analizë statistikore e rezultateve për rezultatet individuale të institucionit por të dhënat përdoren për analizën e përgjithshme ose për ndarjet IAL publike / IAL jo publike.

Analiza e përgjigjeve kryhet në mënyrë statistikore dhe rezultatet janë përmbledhje e përgjigjeve për indikatorë dhe pyetje të ndryshme. Në asnjë rast nuk identifikohet përgjigja me ID apo emrin e individit. *ASCAL garanton anonimatin dhe konfidencialitetin e pjesëmarrësve në të gjitha fazat e realizimit të SKS* (nga dërgimi i aksesit në e-mail-in personal, përpunimin e rezultateve, publikim të informacioneve dhe arkivim të dokumentacionit).

Analiza e të dhënave kryhet në përputhje me qëllimin që ka SKS. Rezultatet paraqiten në mënyrë të përmbledhur për të gjitha institucionet, për dy kategori të ndara (IAL publike / IAL jo publike), dhe rezultate për institucionet që kanë një pjesëmarrje të konsiderueshme në sondazh në raport me numrin total të studentëve.

Rezultati përfundimtar i SKS në nivel institucional apo kombëtar, analizohet me qëllim vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies sipas fushave dhe indikatorëve. Në bazë të përgjigjeve të dhëna, vlerësimet grupohen në 3 grupe: *Jo mirë* – klasifikohet ai indikator ose fushë vlerësimi kur të paktën 80 % e pyetjeve kanë marrë mendim/vlerësim keq dhe /ose jo mirë, *Mirë* – klasifikohet ai indikator ose fushë vlerësimi kur deri në 60 % e pyetjeve kanë marrë mendim/vlerësim mirë, mjaftueshëm dhe /ose shumë mirë dhe *Shumë mirë* – klasifikohet ai indikator ose fushë vlerësimi kur të paktën 80 % e pyetjeve janë plotësuar me vlerësim maksimal.

Në përfundim të çdo fushe jepet vlerësimi përfundimtar: (*Jo mirë* – kur të paktën 5 fusha vlerësimi janë vlerësuar jo mirë - *Mirë* – kur 6 fusha vlerësimi janë vlerësuar mirë, 5 mirë dhe 1 shumë mirë, 4 mirë dhe 2 shumë mirë, 3 mirë dhe 3 shumë mirë, 2 mirë dhe 4 shumë mirë, 1 mirë dhe 5 shumë mirë. - *Shumë mirë* - kur të 6 fushat e vlerësimit janë vlerësuar shumë mirë.

Në manual është parashikuar hartimi i një Raporti përmbledhës me informacione të përgjithshme statistikore për institucionet dhe rezultatet e SKS për të gjitha IAL publike e jopublike në nivel kombëtar. Rezultatet përfundimtare analizohen nga BA dhe MAS, bëhen publike dhe u vihen në dispozicion institucioneve të arsimit të lartë.

**Faza 1:** SKS organizohet sipas strukturës së Kodit të Cilësisë dhe fokusohet në indikatorë/kategori që kanë impakt në cilësinë e mësimdhënies dhe mbështetjen e studentëve dhe mundësojnë vlerësimin e saj. Struktura e SKS është organizuar në 6 fusha në përbërje të së cilave janë grupuar 36 pyetje të kategorive të ndryshme u miratua nga Bordi i Akreditimit me vendim Vendim Nr. 06[2], datë 25.02.2022, "*Për miratimin e pyetësorit, manualit dhe planit të veprimit me afatet kohore të sondazhit kombëtar të studentëve*".

- *Seksioni i parë: Informacion i përgjithshëm*
- *Fusha 1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia*
- *Fusha 2. Vlerësimi dhe feedback-u*
- *Fusha 3. Burimet në funksion të mësimdhënies*
- *Fusha 4. Organizimi dhe realizimi i programeve të studimit*
- *Fusha 5. Mbështetja dhe zëri i studentëve*

*Fusha 6. Vlerësimi i përgjithshëm i programit të studimit/institucionit*

Çdo fushë përmban pyetje të cilat fokusohen në aspekte të veçanta të operimit dhe funksionimit të institucionit ose veprimtarive që ai zhvillon. E plotë, përmbajtja e sondazhit jepet në paragrafin 1, aneksi V të këtij raporti. Grupi më i madh i pyetjeve është në formatin e vlerësimit nga 1 në 5 duke filluar nga mundësia pa përgjigje, vlerësimi minimal në vlerësimin maksimal.

[2] https://www.ascal.al/sq/sondazhi-kombetar-i-studenteve/metodologjia-dhe-instrumentat/sks-2022

Në rastet kur është kërkuar mendim apo koment, studentët kanë patur mundësi të shprehin opinionet e tyre në lidhje me tematika të caktuara.Nisur nga problematika e evidentuar në SKS 2019 si pjesëmarrja dhe besueshmëria e përgjigjeve të studentëve, ASCAL miratoi grupin e punës dhe veprimtaritë paraprake në funksion të zhvillimit të SKS.
Shpallja zyrtare për zhvillimin e SKS u bë me vendim të Bordit të Akreditimit pas të cilit u bë njoftimi zyrtar i institucioneve për zhvillimin e SKS.
Më pas nëpërmjet koordinatorëve institucionalë, është dërguar plani i veprimit dhe janë kërkuar kontaktet e studentëve aktivë në çdo IAL për vitin akademik 2021-2022. Problematika në lidhje me përdorimin e adresa zyrtare të e-mailit nga studentët është përsëri evidente pasi shumë institucione, pavarësisht zhvillimit të mësimdhënies online për gati 2 vjet gjatë pandemisë, përsëri kanë problematikat me saktësinë e e-maileve ose vazhdojnë të përdorin adresa personale e-maili.
Paralelisht ASCAL u angazhua në përgatitjen e infrastrukturës dhe logjistikës së nevojshme për zhvillimin e SKS si platforma, databaza, serveri për ruajtjen dhe mandej arkivimin e informacioneve, trajnimin e koordinatorëve / përfaqësuesëve të IAL dhe studentëve. Gjatë periudhës[3] 1 - 25 Prill janë zhvilluar 80 takime takime me grupet e punës dhe me studentë të IAL-ve përkatëse të cilëve u është shpërndarë dhe broshura informuese e përgatitur për këtë qëllim.




Broshurë dhemateriale informuese për studentët

**Faza 2**: Në datën 25 Prill u shpërnda SKS me email në adresat e studentëve në 39 Institucionet e Arsimit të Lartë në vend (14 IAL publike dhe 25 IAL jopublike). Pyetësori ka qënë i aksesueshëm deri në datën 02.06.2022.
Gjatë periudhës së plotësimit të Sondazhit, ASCAL ka mbajtur komunikime të vazhdueshme nëpërmjet AMS me koordinatoret e 39 IAL-ve, ku i ka informuar për nivelet e pjesëmarrjes dhe ka kërkuar nga grupet e punës dhe IAL marrjen e masave për informimin e vazhdueshëm të studenteve për zhvillimin e SKS.

[3] https://www.ascal.al/sq/informacione/lajme/hapet-zyrtarisht-sondazhi-kombetar-i-studenteve-2022

Është kërkuar të vendosen në dispozicion të studenteve sallat e informatikës/kompjuterat e institucionit për të mundësuar plotësimin e sondazhit (edhe pse sondazhi ishte i aksesueshëm nga çdo lloj mjeti elektronik; telefon, laptop, desktop, tablet, etj); dhe është kërkuar veçanërisht angazhimi i Këshillave/Qeverive Studentore për dhënien e informacionit tek studentet mbi rëndësinë e këtij sondazhi ku për herë të parë të gjithë studentëve u jepej mundësia të shprehin mendimin dhe vlerësimin e tyre për institucionin ku ato ndjekin studimet, në mënyrë anonime duke ruajtur privatësinë dhe pa u ndikuar nga asnjë faktor.

Gjatë fazës së plotësimit të sondazhit janë zhvilluar veprimtari promovuese në bashkëpunim me Ministrinë e arsimit, në median audiovizive dhe rrjetet sociale.duke patur në fokus studentët, sensibilizimin dhe informimin e tyre për SKS.




Takimet informuese të zhvilluara në institucionet e arsimit të lartë

**Faza 3:** Grupi i punës i angazhuar ka përgatitur infrastrukturën për mbledhjen e të dhënave nga pyetësorët e plotësuar, ka shkarkuar të dhënat dhe ka dokumentuar procedurën. Analiza e të dhënave është një proces i gjatë dhe finalizohet pas vlerësimit të të gjitha informacioneve dhe të dhënave. Rezultatet janë shqyrtuar dhe analizuar për t'u bërë pjesë e këtij raporti ku fillimisht jepen rezultate të përgjithshme dhe në anekse janë paraqitur rezultatet e plota për IALP sikundër janë dhënë nga studentët. Ky raport

analitik është dokumenti me rezultatet dhe konkluzionet që nxirren nga sondazhi i realizuar në institucionet e arsimit të lartë.

Pavarësisht angazhimit të ASCAL, thirrjes së vazhdueshme nga IAL për plotësimin e pyetësorit masivisht nga studentët dhe shtyrjes së afatit të përfundimit, përsëri pjesëmarrja e studentëve vlerësohet relativisht e ulët për të dalë në konkluzione të besueshme dhe gjithëpërfshirëse. Në këtë drejtim, edhe SKS 2022 nuk arriti të ketë një pjesëmarrje të lartë të studentëve.

Sikundër kemi paraqitur edhe në seksionin 3, pjesëmarrja në nivel kombëtar e studentëve në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, publike e jo publike është rreth **24329**, ku **14354** në ILAP dhe **9974** IALjP. Kjo pjesëmarrje përbën **21.57 %** të totalit të studentëve që janë kontaktuar në të gjitha institucionet e arsimit të lartë.




Nga 112743 (83616 IALP, 29127 IALjP), sondazhe të dërguara janë plotësuar plotësisht **15638** sondazhe dhe **24329** pjesërisht. Plotësimi për institucionet publike është rreth 17.1 % të studentëve që janë kontaktuar ndërsa në IALjP,është 34.2 % të studentëve të kontaktuar. Kjo do të thotë që pjesëmarrja e studentëve në IALjP është dyfish krahasuar me atë të IALP.

Nëse llogarisim raportin e studentëve pjesëmarrës rezulton se **59 %** janë nga IALP dhe dhe **41 %** në IALjP ccka do të thotë se në peshën e mendimit dhe vlerësimit në këtë sondazh, studentët e IAL publike kanë më shumë peshë kur rezultati paraqitet në nivel kombëtar.

Në SKS 2019, nga 89519 (66905 IALP, 22614 IALjP), sondazhe të dërguara janë plotësuar plotësisht 15591 sondazhe me një mesatare[4] plotësimi për çdo institucion në vlerën 31.2 % (25.67 % IALP, 36.8 % IALjP). Në nivel kombëtar, % e pyetësorëve të plotësuar në raport me numrin e dërguar, kjo vlerë është 17.4 % (14.8 % për IALP dhe 25.1 % në IALjP). Pjesmarrja mesatare në sondazh për të gjitha institucionet publike ka qënë rreth 25.67 %

Referuar të dhënave më sipër, rezulton se SKS 2022 ka një pjesëmarrje pak më të ulët të studentëve krahasuar me SKS 2019 edhe pse në SKS 2022,

[4] Pëqindja e pjesmarrjes është llogaritur nga mesatarizimi i pjesmarrjes të çdo institucioni publik dhe privat duke i dhënë në këtë mënyrë peshën reale që ka çdo student në institucionin e vet.

numri i e-maileve të suksesshëm ka qënë 112743 përkundrejt 89519 në SKS 2019.


Plotësimi i SKS 2022 në IAL nga studentët
UL 312 1872
UNYT 296 666
AU 1140 3197
UZKM 542 2629
A MARUBI 13 19
KU QIRIAZI 106 251
TESS 46 72
UPOLIS 680 1174
UAL 1077 2244
SHL NEHEMIA 37 57
KU PAVARËSIA 204 429
UET 1029 3481
KU BEDËR 213 633
UEPOKA 711 2720
KU WISDOM 218 392
KUB 540 1258
CIT 329 599
TBU 226 469
UMSH 707 3064
UMET 345 1041
KU LOGOS 210 291
KPT 175 227
UB 479 1551
KU REALD 274 459
AI 61 131
USH 1649 7281
UST 570 1530
UK 1129 2956
UGJ 677 1654
UBT 703 7727
UARTE 358 957
UAMD 1634 6669
UE 1895 13751
UV 447 3927
UMT 2079 6131
AS 201 243
UT 1691 20723
UPT 1206 9950
AFA 120 125
0 5000 10000 15000 20000 25000
Pyetësorë të plotësuar
Studentë të kontaktuar

Kjo problematikë nuk vjen vetëm si rezultat i ngelizhencës së studentëve për të marrë pjesë në sondazh por edhe për shkak të motivimit të ulët nga ana e institucioneve.
Në disa institucione, adresat e-mailit të dërguara nga IAL, shumica e tyre nuk janë aktive ose në përdorim nga studentët. Sikundër shihet në grafikun e mëposhtëm, përqindja e studentëve që janë përgjigjur në SKS, janë dhënë përkundrejt studentëve që kanë marrë një e-mail dhe përkundrejt numrit total të studentëve që ka një IAL. Në disa raste diferencat në pasaktësi të adresave të e-mailit janë mjaft të mëdha.
Duhet theksuar se përmirësimet në disa institucione janë minimale përveç Universitetit të Mjekësisë Tiranë, ku pjesmarrja është rritur me rreth 6 % krahasuar me SKS 2019.

Pjesëmarrja e ulët, nga ana tjetër cënon besueshmërinë e SKS 2022. Në këtë kontekst, vlerësimi i përgjithshëm i rezultateve të sondazhit është subjektiv pasi ndikohet jo vetëm nga subjektivizimi në përgjigjet e studentëve por edhe nga analiza statistikore për shkak të kampionit të ulët të studentëve.
Lidhur me përgjigjet e studentëve, subjektivizmi qëndron në faktin se ka dallime midis përgjigjeve të studentëve që studiojnë në institucionet publike dhe institucionet jopublike, institucione të mëdha dhe në institucione të vogla, institucioneve kryesore në vend dhe institucioneve të lokalizuar në qytetet e tjera.
Vlerësimi i studentëve që studiojnë në institucionet jopublike është shumë më pozitiv se ai i studentëve në institucionet publike. Duhet patur parasysh se verifikimi i këtij subjektivizmi është mjaft i vështirë.
Bazuar në konstatimet e mësipërme, ne vlerësojmë se SKS 2022 ka besueshmëri më të ulët rezultatet midis institucioneve publike dhe jo publike dhe rezultatet individuale të IAL veçanërisht kur numri i studentëve është i ulët ose përqindja e pjesëmarrjes në raport me totalin është jashtëzakonisht e ulët.

Nga sa më sipër, për shkak të specifikave dhe kompleksitetit që mbart analiza e të dhënave, ky raport paraqet rezultatet, përfundimet dhe statistikat të vetë studentëve për institucionet e tyre dhe arsimin e lartë në vend pa u thelluar në analiza krahasuese ndërmjet institucioneve për indikatorë apo tregues të ndryshëm.

## 4.2. CILËSIA E MËSIMDHËNIES NË IAL PUBLIKE DHE JO PUBLIKE

Pyetësori i studentëve është ndarë në 7 seksione. Në seksionin 1, fillimisht janë përgatitur pyetjet për çdo institucion. Më pas studentët e çdo institucioni kanë patur të drejtën e përzgjedhjes së fakultetit, programit ku studiojnë, përzgjedhjen e programit, gjinia, mosha. Rezultatet e këtyre pyetjeve janë dhënë në kapitullin 3 të këtij raporti. Në 6 seksionet e tjerë përmbajnë pyetjet sipas fushave kryesore të veprimtarive akademike të institucioneve të arsimit të lartë. Në seksionin 6 studentët pyeten për vlerësimin e përgjithshëm të institucionit duke dhënë mendime për funksionimin dhe cilësinë e treguesëve kryesorë të tij.
Në vijim në paraqiten rezultatet analitike për çdo seksion për të gjitha institucionet në tërësi dhe në mënyrë krahasuese për institucionet publike dhe jo publike. Në disa pyetje, rezultatet paraqiten për programe të ndryshme studimesh apo kategori të ndryshme studentësh. Ritheksojmë se arsyeja kryesore e mosparaqitjes në mënyrë të plotë e krahasuese të rezultateve ndërmjet institucioneve, vjen si rezultat i numrit të ulët të studentëve. Megjithatë, në anekset e këtij raporti janë dhënë rezultatet individuale për çdo IAL. Kështu, raportit analitik i bashkëlidhet rezultatet analitike për institucionin respektiv.

### 4.2.1. Seksioni 1. Mësimdhënia dhe mësimnxënia

Në seksionin 1 të sondazhit, (pyetjet 7 10) kërkohet nga studentët të vlerësojnë aspekte të ndryshme të mësimdhënies dhe cilësisë së saj. Duke dhënë vlerësimin sipas klasifikimit: (1 – aspak dakord; 2) përgjithësisht nuk jam dakord; 3) as po as jo; 4) përgjithësisht dakord dhe 5) plotësisht dakord), studentët kanë vlerësuar:

✓ *Profesorët që më kanë dhënë mësim ishin kompetentë në shpjegim*



- *Po mësoj shumë se si të thellohem në koncepte dhe njohuri*




- *Stafi akademik dhe institucioni më inkurajojnë të marr pjesë në aktivitete studimore (psh. prezantime, detyra, ese, ushtrime, punë në grup, etj.)*




- *Programi i studimit që po ndjek më mundëson që të zbatoj njohuritë teorike në praktikë*

Në vlerësimin e përgjithshëm, mendimi i studentëve është pozitiv për të 4 treguesit e mësipërm. Sikundër shihet në grafikun më poshtë, vlerësimet janë në të njëjtin nivel por ndërkohë, studentët vlerësojnë si më problematike zbatimin e njohurive në praktikë dhe inkurajimin nga ana e personelit akademik për pjesëmarrje në aktivitete studimore.




Për të parë vlerësimin sipas llojeve të institucionit, treguesit e mësipërm janë paraqitur të ndara në mënyrë krahasuese për institucionet publike e jo publike

Në rezultatet e paraqitura në vijim, dukshëm vërehet niveli i vlerësimit më të mirë në institucionet jo publike lidhur me kompetencat e personelit akademik krahasuar me vlerësimin në IAL publike.






Konkretisht, për vlerësimin e kompetencave të personelit akademik, vetëm 36.4 % e studentëve në IAL publike, mendojnë se personeli akademik është kompetent ndërsa po aq përgjithësisht janë dakord me këtë konstatim. Në IAL jo publike, ky rezultat është rreth 62 %.

Edhe në vlerësimin e njohurive të thelluara që jepen në programin e studimit, rezulton se studentët në IALjP janë më të kënaqur me rreth 59 % përkundrejt 38 % në institucionet publike. Mbi 5% janë aspak dakord me këtë konstatim.

Në pyetjen mbi nivelin e zbatimit të njohurive teorike në praktikë, sikundër theksuam më herët, rezulton se studentët vlerësojnë më pak zbatueshmërinë e njohurive në praktikë. Veçanërisht i dukshëm është ky dallim në institucionet publike ku rreth 12 % e studentëve nuk janë aspak dakord me këtë pohim.




IAL jopublike: Po mësoj shumë se si të thellohem në koncepte dhe njohuri
Plotësisht dakord
58.70%
Përgjithësisht dakord
26.00%
As Po as Jo
10.35%
Përgjithësisht nuk jam dakord
3.19%
Aspak dakord
1.76%
0
10
20
30
40
50


Profesorët që më kanë dhënë mësim ishin kompetentë në shpjegim
Institucion jo publik
Program profesional (1 - 2 vjet)
443
Program Master Profesional (1 - 2 vjet)
172
Program Master i Shkencave (2 vjet)
658
Program i Integruar Master i Shkencave (5 - 6 vjet)
698
Program Bachelor
2883
Institucion Publik
Program profesional (1 - 2 vjet)
322
Program Master Profesional (1 - 2 vjet)
534
Program Master i Shkencave (2 vjet)
335
Program i Integruar Master i Shkencave (5 - 6 vjet)
285
Program Bachelor
2162
0
2000
4000
6000
8000
Aspak dakord
Përgjithësisht nuk jam dakord
As Po as Jo
Përgjithësisht dakord
Plotësisht dakord

Edhe në vlerësimin e mbështetjes nga personeli për inkurajimin e studentëve për tu angazhuar në veprimtari të ndryshme, institucionet jopublike, dukshëm kanë vlerësim më pozitiv se ato publike (64% me 38%).







I njëjti vlerësim jepet edhe për ndërlidhjen e studimeve me praktikën ku dukshëm në IAL jopublike me rreth 60% të studentëve përkundrejt 35 % të IAL publike.







Në përfundim, bazuar në përgjigjet e dhëna, vlerësimi i studentëve për indikatorët e vlerësimit të fushës 1, "*Mësimdhënia dhe mësimnxënia*", është në nivel mesatar duke identifikuar dy indikatorë si më problematikë:

- ✓ *Stafi akademik dhe institucioni më inkurajojnë të marr pjesë në aktivitete studimore psh. prezantime, detyra, ese, ushtrime, punë në grup, etj.*
- ✓ *Programi i studimit që po ndjek më mundëson që të zbatoj njohuritë teorike në praktikë*

Bazuar në këto rezultate, institucionet publike dhe personeli akademik, duhet të inkurajojnë më shumë studentët të marrin pjesë në aktivitete studimore psh. prezantime, detyra, ese, ushtrime, punë në grup, etj, dhe programet të mundësojë zbatimin e njohurive teorike në praktikë veçanërisht në institucionet publike.
Nga sa më sipër, referuar manualit të SKS, konkluzioni përfundimtar i vlerësimit të fushës 1, është në nivelin mesatar nga studentët.

### 4.2.2. Seksioni 2: Vlerësimi dhe feedback-u

